



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.735/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Mirusha Company” SH.P.K., me seli në Klinë, rr.“Abedin Rexha” p.nr., të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “Legus” SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Klinës, e përfaqësuar nga A.Sh. sipas autorizimit, me bazë juridike përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpp.nr.59/2020 të datës 11.02.2021, me datë 30.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Mirusha Company shpk me seli në Klinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpp.nr.59/2020 i datës 11.02.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar Cpp.nr.59/2020 të datës 11.02.2021 në pikën I të dispozitivit ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Klinës të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat Isa Shala në Prishtinë, P.nr.415/2020 të datës 31.08.2020. Në pikën II të dispozitivit ka shfuqizuar Urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat Isa Shala në Prishtinë P.nr.415/2020 të datës 31.08.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të aprovet si e bazuar ankesa dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Mirusha Company” SH.P.K., me seli në Klinë, rr.“Abedin Rexha” p.nr., me datë 31.08.2020, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Komuna e Klinës, në bazë të dokumentit besueshëm – faturës nr.28-072020 të datës 30.07.2020, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 85,840.30 €.

Përmbartuesi privat Isa Shala, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.415/2020 të datës 31.08.2020, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 15.09.2020 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se propozimi për përmbartim dhe urdhri përmbartimor janë të pabazuar dhe të palejuar në tërësi, sikundër që tërësisht urdhri kontestues është i pa ekzekutueshëm ngase nuk përmban kushtin kryesor ligjor për faktin vendimtar se fatura kontestuese nuk ka qenë fare e dërguar në mënyrë të rregullt dhe as e pranuar nuk e ka nënshkrimin e debitorit pra e njëjta nuk mund të konsiderohet dokument i besueshëm. Tutje debitori ka deklaruar në prapësim se me kreditorin kanë pasur të lidhur një kontratë kornizë për kryerjen e shërbimeve për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve për sezonin 2019-2020 me nr.01-20145905/19 të datës 08.11.2019, e cila kontratë ka përfunduar me datë 30.05.2020 si kohe e përfundimit të sezonit dimërorë. Debitori ndaj kreditorit ka kryer obligimin e tij të pagesës mbi bazën e gjendjes së shërbimeve faktike dhe reale të kryera, shumën prej 18,892.63 Euro, bazuar në nenin 3.9 të kontratës lëndore. Ndërsa kërkesa e kreditorit për pagesën e 70 % nga vlera e përgjithshme e kontratës, nuk është e paraparë me asnjë nga dispozitat dhe kushtet e kontratës as në ato të përgjithshme e as tek ato të veçantat prandaj kërkesa e tillë për pagesë është e porealizueshme dhe e pa bazuar pasi që faturimi i tillë nuk ka mbulesë juridike – kontraktuese dhe as kryerje faktike të shërbimeve – punëve të tilla pretenduese, andaj ka propozuar që të miratohet në tërësi prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor duke anuluar të gjitha veprimet përmbartimore.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 22.09.2020, me të cilin ka kundërshtuar në tërësi prapësimin, me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë të pabazuara për arsye se fatura është dërguar me postë dhe e njëjta është pranuar nga debitori e cila nuk është kundërshtuar nga debitori, llogaritja e faturës është bërë në bazë të procesverbalit të datës 30.07.2020 ku është bërë matja e sasisë së kripës në deponin e kreditorit në prani të komisioni të formuar nga ana e debitorit edhe palës kreditore. Po ashtu fatura është deklaruar në ATK, që dëshmon se fatura është e rregullt

dhe i plotëson të gjitha kushtet ligjore, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi dhe të lejohet urdhri përmbartimor si i bazuar.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar Cpp.nr.59/2020 të datës 11.02.2021, me të cilin në pikën I të dispozitivit ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.415/2020 të datës 31.08.2020, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat Isa Shala P.nr.415/2020 të datës 31.08.2020, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se dokumenti përmbartimor – fatura në bazë të se cilës kërkohet borxhi nuk është nënshkruar dhe pranuar nga pala debitori, çka nënkupton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e këtij urdhri përmbartimor të lejuar në bazë të kësaj fature e cila nuk ka titull ekzekutiv, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, ashtu siç parasheh neni 21 i LPP-së, lidhur me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.3 dhe paragrafi 3 të LPP-së. Tutje gjykata ka arsyetuar se debitori i ka bërë pagesën kreditori për punët e kryera në vlerë prej 15,892.50 Euro, menjëherë pas ofrimit të faturës bashkë me ditarin e punës që vërteton punët e kryera dhe materialin e shpenzuar konform kontratës nr.221-45905/19 të datës 08.11.2019. Dhe se kërkesa për pagesën e 70 % të shumës së totale në vlere prej 120,000.00 Euro e bërë në llogari dhe shprehur në faturën nr.28-072020 të datës 30.07.2020 në shumë prej 85.840.30 Euro nuk është e precizuar në kontratë e që nuk ka bazë për të kosnsituar me këtë pasi që është edhe në kundërshtim me nenin 3.1 të kontratës në fjalë ku thuhet se: “Çmimet janë për njësi dhe do te jenë bazë për llogaritjen e shërbimeve sipas nevojave dhe kryerjes së shërbimeve në teren”. Gjykata ka arsyetuar po ashtu se në rastin konkret kontrata në fjalë është burim i detyrimeve që rrjedhin nga raporti juridiko – civil i kreditori dhe debitorit të cilët përmes saj kanë rregulluar të drejtat dhe detyrimet lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve gjate sezonës së dimrit, gjë që është objekt i kontratës dhe njëherit detyrim i palës kontraktuese.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbartim. Dhoma e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin kur ka konkluduar se fatura në bazë të së cilës

është lejuar përmbarimi është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori dhe e njëjta nuk është pranuar nga ana e debitorit.

Sipas nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.3 të LPP-së, përcaktohet se: “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe *faturë kthyesë*, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës;” dhe 1.3. *faturat*, ndërsa me paragrafin 3 të të njëjti nen, shprehimisht përcaktohet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Rrjedhimisht, në rast të mungesës së ndonjërit nga këto elemente dokumenti konsiderohet i papërshtatshëm për përmbarim.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, kjo gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin e debitorit me arsyet se urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e faturës e cila jo vetëm se nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori por e njëjta është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e kontratës së lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse 01 Nr.221-45905/19 të datës 08.11.2019, me të cilën janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet për palët nënshkruese, në rastin konkret për debitorin dhe kreditorin. Me shqyrtimin e shkresave të lëndës shihet se pala debitore detyrimin për një pjesë të punëve të kryera nga ana e kreditorit në bazë të kontratës 01 Nr.221-45905/19 të datës 08.11.2019 e kishte përmbushur, ndërsa detyrimin e kërkuar në bazë të faturës kontestuese e ka kundërshtuar pasi që pala kreditore nuk ka kryer punë për debitorin që i njëjti të kompensohet në shumën e kërkuar me faturën në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e që edhe kësaj gjykate kundërshtimet e debitorit i rezultojnë të themelta pasi që borxhi i kërkuar në bazë të faturës kontestuese nga ana e kreditorit nuk është i bazuar dhe nuk gjen mbështetje në provat shkresore, kjo për arsyes se pala debitore e ka arsyetuar me prova konkrete se kreditori nuk ka kryer punë për debitorin për shumën e kërkuar që i njëjti të kompensohet në bazë të faturës e cila faturë kontestuese në rastin konkret rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit. Me dispozitat e kontratës së lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse konkretisht me nenin 3 të Kontratës 01 Nr.221-45905/19 të datës 08.11.2019 në mënyrë decidive theksohet se: “Çmimet janë për njësi. Dhe do të jenë bazë për llogaritje të shërbimeve sipas nevojave dhe kryerjes së shërbimeve në teren”, ndërsa me pikën 3.9 të të njëjtës kontratë është paraparë pagesa e punëve të kryera të bëhet: “Dhe atë me faturë dhe raport mbi kryerjen e punëve, jo më larg se 30 ditë pas pranimit të faturës dhe raportit”. Andaj në bazë të dispozitave të kontratës së lartcekur kreditori kërkon të kompensohet për punët të cilat i njëjti nuk i ka kryer ndaj debitorit, e të cilat po të ishin kryer do të ishin vërtetuar në bazë të dokumenteve ligjore që verifikojnë shërbimet e kryera siç është ditari i punës si dhe nga raportet e organit mbikëqyrës të kontratës konkretisht menaxherit të projektit, çka nënkupton se fatura nuk është lëshuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se dhoma e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se prapësimi është i bazuar, ngase fatura në bazë të së cilës është lëshuar urdhri përmbartimor, nuk mund të trajtohet si dokument i besueshëm në kuptim të dispozitave të LPP-së. Pretendimet ankimore se fatura përmbartimore i është dërguar me postë debitorit, të cilën edhe e ka pranuar debitori, gjykata i konsideron këto pretendime të papranueshme për tu konsideruar se fatura nr.28-072020 datë 30.07.2020 është dokument i përshtatshëm për përmbartim, sepse me lëshimin e kësaj fature në mënyrë të njëanshme pa pëlqimin, pranimin e faturës nga debitori, në këtë mënyrë, nuk vërtetohet se debitori ka pranuar pagesën e borxhit sipas faturës në bazë të së cilës është iniciuar propozimi për përmbartim.

Kjo gjykata vlerëson se ankesa e kreditorit është e pathemeltë pasi që kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar pretendimet e veta, për vendosjen ndryshe ngase është vendosur me aktvendimin e ankimuar.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të së drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.735/2023 me datë 30.01.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha